



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova

The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals	
Broj. prot. / Prot. no. / No. page: 486	Archive: -1-
Date: 22.04.24	Date: 22.04.24

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 14 paragrafi 1.3, nenit 26 të Statutit të Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues, me date 22.04.2024 nxjerrë këtë:

## PLOTËSIM NDRYSHIM

### I

## VENDIMIT Nr.Prot 286

### *Për kriteret dhe procedurat e provimit profesional të Ri licencimit*

- Të drejtë për hyrje në provim kanë kandidatët të cilëve i ka skaduar afati i licencës në periudhë prej jo më shumë se 60 ditësh para skadimit të licencës, dhe të cilët nuk kanë arritur kriterin e paraparë të pikëve kredituese për ri licencim.
- Kandidatëve të cilëve iu ka skaduar licenca në afat jo më shumë se 6 muaj kanë të drejtë në ri licencim duke iu valorizuar pikët kredituese të fituara në afatin kohor 6 muaj nga data e skadimit.
  - Kandidatët të cilët kanë fituar së paku 50% të pikëve brenda afatit kohor 6 muaj nga data e skadimit, por që nuk kanë arritur kriterin për ri licencim përmes edukimit të vazhdueshëm profesional, paguajnë 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. Prot 637 të datës 04/05/2023.
  - Të gjithë kandidatët të cilët posedojnë 0-49 pikë kredituese, paguajnë taksën e plotë për provimin profesional të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr.prot 637 të datës 04/05/2023.
  - Kandidatët e pa punësuar Anëtarë të OIK, brenda afatit kohor 6 muaj nga data e skadimit paguajnë taksën 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues. Kandidatët duhet të dëshmojnë përmes vërtetimit nga Trusti Pensional i Kosovës.
- Të gjithë kandidatëve, të cilëve iu ka skaduar afati i licencës më shumë se 6 muaj nga data e skadimit, pa marrë parasysh sigurimin e pikëve kredituese, obligohen të ju nënshtrohen provimit profesional të ri licencimit, dhe paguajnë taksën e plotë të provimit të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. Prot 637 të datës 04/05/2023.
- Kandidatët të cilët arsyetojnë me dëshmi mjekësore mos arritjen e pikëve kredituese për ri licencim dhe mos aplikimin me kohë për shkak të sëmundjes, lirohen nga obligimi i arritjes së pikëve akredituese për kohën të cilën e dëshmon me raport mjekësor në të cilën konstatohet natyra serioze e sëmundjes.
- Kandidati i cili ka dështuar në njërin nga lëndët e Provimit Profesional të Ri licencimit lirohet nga kjo taksë për Ri provim në atë lëndë, ndërsa kandidati i cili ka dështuar në dy apo më shumë lëndë të provimit profesional të Ri licencimit, obligohet ti nënshtrohet të gjitha provimeve dhe të paguaj taksën e plotë të provimit.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr.Prot 1290
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i KD të OIK-ut

Bashkim Mehmeti



Kryetare e OIK-ut

Ma. Nexhmije Gori